



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 22/05/2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 20.05.2020, të parashtruar nga grupi i Operatorëve Ekonomik **PRO&CO GROUP SHPK & DT MNING SHPK** -Klllokot, Viti, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadime e Ulët, rrugët("Mirdita", "Rexhep Hashani", "Nëna Terezë")-kontratë dyvjeçare**, me Nr. të Prok: **613-020-1377-5-2-1** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e grupit të Operatorëve Ekonomik **PRO&CO GROUP SHPK & DT MNING SHPK** -Klllokot, Viti e datës 20.05.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadime e Ulët, rrugët("Mirdita", "Rexhep Hashani", "Nëna Terezë")-kontratë dyvjeçare**, me nr. të Prok: **613-020-1377-5-2-1** kundër Vendimit të AK-së, të datës 18.05.2020 (Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues) të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** Vendimi i AK për shpërblim me **kontratë**, për Operatorve Ekonomik Bujar Shabani B.I – Ferizaj, të publikuar me datë: **18.05.2020**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Grupit i Operatorëve Ekonomik **PRO&CO GROUP SHPK & DT MINING SHPK** -Kllokot, Viti me datë 20.05.2020 ka parashtruar ankesë lidhur me aktivitetin e prokurimit **Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadime e Ulët, rrugët ("Mirdita", "Rexhep Hashani", "Nëna Terezë")-kontratë dyvjeçare**, me nr. të Prok, **613-020-1377-5-2-1** dhe nr. brendshëm 613 020 022 521 për shpërbllim me **kontratë**, Operatorin Ekonomik **Bujar Shabani B.I – Ferizaj**, të datës 18.05.2020 te publikuar ne platformen elektronike e-prokurimi.

Autoriteti Kontraktues, me datë 21.05.2020, ka shqyrtuar kërkesën e OE ankues si më poshtë:

Në kërkesën për rishqyrtim nga OE ankues, ne si autoritet kontraktues kemi konstatuar se pretendimet e OE ankuesit janë të paarsyeshme. Në tabelën e më poshtme, që në fakt është tabelë përmbledhëse e të gjitha rrugëve të cilat duhet asfaltohen, nuk keni përfshi edhe **AXIS _10** (Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme). Paramasa, nga ana e juaj, ka qenë mirë e plotësuar duke e përfshi edhe **AXIS _10**, por nuk është inkorporuar në tabelë, gjë që në llogaritjen përfundimtare matematikore del se gabimi është mbi 2% (rrespektivish rreth 2.7% (toleranca e gabimeve në bazë të nenit 59 paragrafi 3 Ligjin për Prokurim Publik nr 04L-42 i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin nr 04L -247 dhe Ligjin 05L-068 , është deri 2%)

R E K A P I T U L I M I		
Nr.	Përshkrimi	Vlera me TVSH në €
I	(AXIS_1) Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme	€ 4,957.50
III	(AXIS_3) Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme	€ 3,052.70
IV	(AXIS_4) Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme	€ 5,284.51
V	(AXIS_3+) Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme	€ 5,935.16
VI	(AXIS_6) Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme	€ 8,142.78
X	(AXIS_11) Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme	€ 4,892.64
XII	(AXIS_12) Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme	€ 6,896.49
XIII	(AXIS_13) Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme	€ 12,583.37
XIV	(AXIS_14) Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme	€ 4,512.45
XV	(AXIS_15) Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme	€ 18,678.69
XVI	(AXIS_16) Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme	€ 2,634.76
XVII	(AXIS_17) Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme	€ 5,401.53
XVIII	(AXIS_18) Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme	€ 20,184.61
XIX	(AXIS_15b) Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme	€ 2,427.05
XX	(AXIS_7) Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme	€ 10,169.45
XI	(AXIS_20) Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gadime e Poshtme	€ 25,361.91
TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH		€ 141,115.59

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Adem Duriqi

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

